

**STATUTI DHE AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ BLUE MONKEY ” SHPK**

Ne Tirane,sot me date 01/02/2022,u paraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Z. URIM VATA**, i biri i Avdiut, i datëlindjes 01/06/1979, lindur në Surroj/Kukes dhe banues ne Tirane, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal H90601200F, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Z. SHPETIM DANI** i biri I Kasamit, e datelindjes 23/03/1983, lindur në Morin / Kukes dhe banuese në Tiranë, identifikur me kartë identiteti me nr. personal I30323158K.
3. **Z. KLAJDI ZHULI** i biri I Islamit, e datelindjes 16/10/1990, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Tirane identifikur me kartë identiteti me nr. personal J01016088E.

Te cilet hartojne kete Akt –Themelimi dhe Statut te shoqerise“ **BLUE MONKEY ” SHPK, me emer Tregetar “Votra 2”**mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008,“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“,i ndryshuar,ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,Kodin Doganor,Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria“ **BLUE MONKEY ” SHPK, me emer Tregetar “Votra 2”** eshte person juridik i te drejtes shqiptare,Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).


Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria,pasi të ketë fituar personalitetin juridik,është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “ **BLUE MONKEY ” shpk, me emer Tregetar “Votra 2”** eshte nje shoqeri,që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar



Neni 3
Selia


Shoqeria e ka seline ne Tirane ne adresen Rruga e ish Fusha e Aviacionit ND.20 Nr pasurie 1/472-n1/2 TIRANE
Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij,te hape zyra perfaqesie,dege,te krijojte filiale,si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise,vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte: Bar Kafe , Restorant , organizime eventesh ,festash te ndryshme,hoteleri,turizem, reklamime te ndryshme përgatitje udhëtimesh . Menaxhim të Catering.Organizim të kongreseve, evenimenteve speciale, panairove.Shërbime komisioni reklamash, ideim, realizim, prodhim reklamash televizive në mediat elektronike dhe të shkruara.Import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë e mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industrialë, mallrave alkolike te akcizes.Ofrimi i shërbimeve në fushën e ushqimit nëpërmjet klubeve te nates, restoranteve, ëmbëltoreve, fast fond-eve,etj. Blerja shitja dhe administrimi i pasurive të patundshme të cilat janë në interes të Shoqërisë. Transport udhetaresh Kombetare dhe Nderkombetare per nevojat e veta dhe te treteve.Kryerja e sherbimeve te mirembajtjes etj
Shoqeria mund te bashkohet dhe te marre pjese edhe vullnetarisht ne konsorciume per prodhimin dhe tregtine,si dhe te marre pjese ne siper marrjet e perbashketa per iniciativa te caktuara te biznesit ose industrise; te marre pjese ne shoqata,konsorciume dhe organizata qe kane tendence per te lehtesuar dhenien e kredive me kushte të favorshme, ose granteve. Mund te marre kredi dhe / ose hua nga ortakët si dhe nga shoqerite e grupit (shoqerite meme, filialet dhe bashkepunetoret),qofte me kamate ose interes zero ose me norme detyruese per rikthim ne natyre.
Shoqeria mund te kryejte transaksione financiare,dhe te pasurive te paluajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimit te shoqerise,te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekt te njejte,te ngjashem apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor,si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakëve dhe ne favor te te treteve.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise “ BLUE MONKEY ” SHPK eshte e pakufizuar.



KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë (njqind mijë leke) e barabarte me 3 kuota.

- a) Ortaku **Z. URIM VATA**, është zoterues në masën 40 % e barabarte kjo me 1 kuota.
- b) Ortaku **Z. SHPETIM DANI**, është zoterues në masën 30% e barabarte kjo me 1 kuota.
- c) Ortaku **Z. KLAJDI ZHULI**, është zoterues në masën 30 % e barabarte kjo me 1 kuota.

Kontributi(kapitali aksionar) i ortakeve është në para(leke).

Ortakët e ardhshëm kanë dërdhur shumën korresponduese të pjesëve të nënshkruara.

Ortakët që firmosin këtë akt pasi ka marrë dëjën për këtë certifikatë, një kopie ekzakte e së cilës është paraqitur atij deklaron se shumën e mësipërme është në përputhje me atë që shënohet në certifikatë dhe se ato konfirmojnë nënshkrimet e pjesëve të kapitalit themeltar në përputhje me shumën respektive të dërdhur.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3vjetëve nga çasti i cenimit.


Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- 1.a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

- 1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 2. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
- 3. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga **KLAJDI ZHULI** ,sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripertesitje.

Asambleja e pergjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakeve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakerisë.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transfera, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.


Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi,do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare",Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akti themelimi,si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike,ne gjuhen shqipe,u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare “ **BLUE MONKEY** ” *shpk*, me emer Tregetar “Votra 2” nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin,mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES
TE SHOQERISE “ BLUE MONKEY ” SHPK

Ortaku Z. URIM VATA.

Ortaku Z. SHPETIM DANI.

Ortaku Z. KLAJDI ZHULI

